

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Edhe unë dua të ndaj shqetësimin që ju artikuloat pak më parë në lidhje me ndryshimin e emrave të folësve. Aktualisht kemi një listë folësish digjitale, një të printuar dhe një të tretë, që e dini dhe e zbatoni vetëm ju. Në një kohë që parlamenti është investuar për një platformë moderne digjitale, nuk ka arsye pse t'i shmangemi asaj dhe të çorientohemi në drejtime të ndryshme. Dua të them edhe diçka tjetër për Rregulloren. Do t'ju lutesha të këshilloheshit edhe një herë me të, sepse as Kryeministri, as zëvendëskryeministri, sado që mund t'ju emocionojnë ju personalisht, nuk mund ta marrin fjalën në një kohë që një folës tjetër është komunikuar për të diskutuar. Vetëm pas atij, mund të flasim. Kjo jo vetëm për arsye të Rregullores, por edhe për arsye etike. Për sa i përket projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për ngritjen e qendrës së përbashkët policore dhe doganore", dua të theksoj që në fillim se është një marrëveshje e munguar dhe e vonuar, është një marrëveshje, për të cilën ne si Kuvend nuk duhet të përqendrohemi në faktin e ngritjes së kësaj qendre, por në aspektin e funksionimit të saj. Krimi nuk njeh kufij dhe shpeshherë është më i zhdërvjellët në bashkëpunimin ndërkuftar sesa strukturat nacionale dhe ndërshtetërore të destinuara për luftimin e tij. Pasojat janë shumëplanëshe; janë në lëmin e sigurisë, të shoqërisë e kështu me radhë.

Prandaj, duhet që qeveria, jo si në rastet e tjera që nënshkruan marrëveshje të tilla për formalitet, të përqendrohet në implementimin rigoroz të saj, sepse jemi një vend problematik, që është eksportues i natyrave të ndryshme të krimit të organizuar dhe kryesisht atij të fushës së narkotikëve. Nuk dua të zgjatem më tepër për këtë projektligj, por doja të theksoja diçka që përmendet në relacionin shoqëruar të tij. Kjo nuk është një marrëveshje që synon përafrimin me të drejtën komunitare, por është konform standardit komunitar të Bashkimit Europian. Këtu duhet të jetë fokusi ynë. Kemi humbur shumë kohë me integrimin. Dëgjova parafolësin të thoshte se jemi shumë të avancuar me procesin e integritimit dhe ne nuk e paskemi marrë vesh, në një kohë që jemi të fundit. Kjo është e njëjta gjë me humbjen e ndeshjes 3 me 0, ndërkohë që kemi bërë më shumë goditje këndi. Ky është mentaliteti i kësaj qeverie. Kur një qeveri është e karakterizuar në veprimtarinë e vet nga vitrina, prej saj nuk mund të pritet substancë dhe që të prodhohen rezultate konkrete. Më lejoni t'i referohem po në këtë kuadër një aspekti tjetër shumë të rëndësishëm. Me Republikën e Greqisë kemi gjashtë pika të kalimit kufitar, plus atyre detare. Dy prej tyre, ajo e Sopik-Drimadhes dhe ajo e Rips - Abelonas janë të paaksesueshme, zotërinj, nuk kanë infrastrukturën e nevojshme rrugore për t'u quajtur pika të kalimit ndërkufitar, aq më tepër me një shtet të Bashkimit Europian. Këtu janë ministri i Brendshëm dhe ministrja e Turizmit.

A e kuptoni që zona e Pogonit, ku ndodhet pika e Sopik - Drimadhes dhe zona e Zagorisë ngjitur me të, nuk kanë një rrugë elementare që t'i lidhë, si me Gjirokastrën, ashtu edhe me pikën e kalimit kufitar? Janë zona me potenciale turistike, janë zona me tradita historike, me një trashëgimi kulturore të paprecedentë, të cilat rrënohen, janë të braktisura, janë jashtë vëmendjes së shoqërisë. E kuptoni se sa i shumëfishtë do të ishte ndikimi i shndërrimit të kësaj pike kufitare në të aksesueshme? E njëjta situatë është edhe në pikën kufitare të Rips-Abelonas. Është e paaksesueshme. Në periudhën e dimrit duhet të jesh aventurier që t'i nisesh edhe me këmbë, sepse fenomenet klimaterike ndikojnë në atë masë që e bëjnë atë të pakalueshme. Rrjedhimisht, është çështje zhvillimi, është çështje demografike,

është çështje sigurie. Përqendrohuni te thelbi. Bëni një herë këto dhe pastaj shikoni edhe aeroportin e Vronit apo edhe gjëra të tjera. Krijoni njerëzve kushte njerëzore. Është prioriteti i prioriteteve për një politikë. Në fund dua të flas për aspektin tjetër të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë. Është fatkeqësi, zotëri dhe zotëri, sepse në një kohë që qeveritë e dy vendeve kanë një luks të veçantë, marrëdhëniet midis dy popujve kanë kapërcyer me vite dhe dekada mentalitetin mbizotërues të pushtetarëve. Në një kohë të tillë përfaqësuesi i grupit parlamentar të maxhorancës fiktive të këtij parlamenti insiston me teori paragjyimesh dhe stereotipash, që nuk kanë asgjë të ndryshme nga teoritë e konspiracionit. Zotëri, të paktën shumica e qytetarëve që jetojnë këtu, sepse ndoshta ju nuk e ndani këtë vizion, ka vendosur të jemi europianë. Deri tani ju jeni barriera, jeni pengesa, për arsyet tuaja apo për aftësinë tuaja, këto do t'i tregojë koha. Nuk ka partnerë të NATO-s dhe Bashkimit Europian që i mbështesin marrëdhëniet e tyre në allishverishe, siç jeni mësuar ju me arkadashët tuaj të Anadollit. Marrëveshjet me partnerët nuk janë marrëveshje shit-blerjesh, por ato të respektimit reciprok, të benefiteve të ndërsjella, ato që kontribuojnë në përmirësimin e realiteteve të të dyja vendeve. Përfundimisht, zhvishuni nga këto koncepte, sepse edhe interlokutorët tuaj europianë kur ju shikojnë, e konstatojnë që në momentin e parë sa të papërgatitur jeni ju si qeveri për të çuar këtë vend në hapat që na presin përpara në procesin e integritit. Shikoni ku ka avancuar statusi i integritit të Republikës së Shqipërisë në NATO dhe në Bashkimin Europian dhe ku është penguar ose është ngadalësuar.

Në momentet që me Republikën e Greqisë ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe interesi dypalësh për avancimin e tyre, Shqipëria ka ecur përpara. Në vitin 2003 Shqipëria u integrua në planin e Bashkimit Europian me iniciativën e Selanikut, u anëtarësua në NATO në vitin kur marrëdhëniet midis dy qeverive dhe vendeve kishin arritur nivele shumë të larta dhe në vitin 2014 ishte po përsëri presidenca greke, e cila i dha statusin e shumëpritur të vendit kandidat për në Bashkimin Europian. Ndaj, zotëri, mos u endni larg në mentalitete në ndërmarrje politike dhe qeveritare, por përqendrohuni tek aleatët që janë partnerë të së ardhmes sonë, që janë në mënyrë të provuar avokatë të integritit europian dhe të plotësisht të aspiratës themelore të qytetarëve të këtij vendi. Faleminderit!